

Multi Idea

**Aktivitetet e
Multikulturës**

Dita e dallimeve

**Puna në tv, lodhje
dhe kënaqësi**

Intervistë me
Luana Vjollca

**Ballkani si
metaforë**

Salajdin Salihu

Çka është PR?

Imazh, besim dhe marketing

**Pemë dhe perime
për organizëm
të shëndetshëm**

MULTIKULTURA TETOVË

SË BASHKU ME ORGANIZATAT TJERA PARTNERË TË RRJETIT

AKSION REGIONAL I TË RINJVE KUNDËR DISKRIMINIMIT DHE MILITARIZMIT

Ditët e veprimit

kundër diskriminimit dhe militarizmit

2012

15 maj
- E Martë -

12:00 - 16:00; Para
Qendrës së Kulturës, Tetovë
Ditët e aksionit së bashku me
Ditën e dallimeve
Shtand promo-informues
"Peace Days Corner"
- Artistë të rinj pikturojnë
motive për paqe,
anti-diskriminim
dhe anti-militarizëm.

7 maj
- E Hënë -

Universiteti i Evropës Juglindore
Info-pult për Ditët e aksionit
kundër diskriminimit dhe militarizmit



24 maj
- E Enjte -

Vizitë në
shkollën e mesme
"Niko Nestor" në Strugë
Promovim i Ditëve të aksionit
para nxënësve të shkollës
"Niko Nestor" të Strugës
dhe bashkëbisedë për format
e diskriminimit në
bashkësinë lokale.

31 maj
- E Enjte -

Universiteti i Evropës Juglindore
10:00 - 12:00 Debat
publik rreth temës
"Diskriminimi në punësim"



"Ky publikim u mundësua në suaza të programit CIVICA Mobilitas - implementuar nga CIRa dhe financiarisht e mbështetur nga SDC. Mendimet e shprehura këtu janë mendime të autorit/autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e CIRa-së dhe SDC-së."

Botues:

Multikultura

Kryeredaktor:

Pranvera Kasami

Redaktor përgjegjës:

Arlinda Mazllami

Lekturimi:Salajdin Salihu
Hristina Vasilevska**Përkthimi:**Rabije Musai
Selima Shaqiri
Teuta Bajrami**Dizajni:**

Fisnik Shabani

Adresa:Jane Sandanski, nr.48/1
1200 Tetovë
tel: +389 44 522 355
e-mail: info@multikultura.org.mk

www.multikultura.org.mk

Dikush bën diçka që për tjetrin duket e thjeshtë, por madhështia e sendeve tek thjeshtësia dhe çiltësria e qëllimit të mirë qëndron.

Kjo revistë, e fokusuar kah problematikat rinore, është një, nga të shumtat aktivitete që organizohen për të promovuar vlerat, me të cilat rinia jonë, diverse-por në thelb e njejtë, disponon.

Të gërshetosh realitetin dhe ëndrrën, teorinë dhe praktikën në një tërësi do shumë lodhje, djersitje madje. Ama, kur vullneti ekziston dhe ka shenja drite se qëllimi arrihet, barra i'a vlen qirranë. Ashtu edhe ne, gëzohemi kur bëjmë të përmbushen pritjet e grupit tonë shënjestër-siç quhet, të rinjve.

Gëte ka thënë: Edhe pse bota ecën përpara, të rinjtë prapseprapë duhet të nisen nga fillimi.

Ne jemi një dorë e zgjatur për t'i ofruar rinisë sonë një fillim të ri e të mbarë!

Nga**Redaksia****përmbajtja:**

Aktivitetet e Multikultrës.....	4
Dita e dallimeve.....	7
Intervistë me Luana Vjollca.....	9
Ballkani si metaforë.....	10
Çka është PR? Imazh, besim dhe marketing.....	12
Mësova të shikoj botën me sy fëmijësh.....	13
Shqiptarë të shquar.....	15
Jeta e një studenti.....	17
Recension – Familja si shpëtim.....	18
Tres metros sobre el cielo.....	18
Diabeti, kjo sëmundje e shekullit.....	19
Pemë dhe perime për organizëm të shëndetshëm.....	20
Të dhënë pas FC Barcelonës.....	21
Fjalëkryqi.....	22

Multikultura në kornizën e programit vjetor të mbështetur nga CIVICA Mobilitas, organizon aktivitete të ndryshme që i plotësojnë nevojat e të gjithë qytetarëve, dhe të rinjve në veçanti.

8 Prill – Dita e Romëve

Me rastin e 8 Prillit–Ditës Ndërko-mbëtare të Romëve, nxënësit romë nga të gjithë shkollat fillore në Tetovë, të cilët janë pjesë e projektit “ Një hap përpara për edukim më të mirë të fëmijëve romë” e shënuan këtë ditë. Ceremonia ishte pjesë e projektit dhe u mbajt në shkollën fillore Goce Dellçev në Tetovë, më datë 8 Prill 2011 me fillim në ora 17:00.

Ky aktivitet u organizua me iniciativë të vet tutorëve dhe studentëve, të cilët kishin mbështetje nga ana e dy organizatave joqeveritare Multikultura dhe Sonce.



Kuiz i njohurive

Multikultura në bashkëpunim me OJQ Sonce, Tetovë dhe Meseçina, Gostivar ka organizuar 3 kuize të njohurive për nxënësit romë. Kuizi i parë është mbajtur në shkollën fillore “Naim Frashëri”, Tetovë më datë 28 Prill 2011, kuizi i dytë është mbajtur më datë 21 Maj 2011 në shkollën fillore “Bashkimi”, Gostivar dhe kuizi i tretë ishte më datë 9 Dhjetor, 2011 në shkollën fillore “Kirili dhe Metodij”, Tetovë.

Pjesëmarrësit e kuizit ishin 36 nxënës romë nga 8 shkolla fillore në Tetovë dhe Gostivar, të cilët ishin të ndarë në 6 grupe. Fëmijëve u janë shpërndarë dhurata simbolike.

Ditët e paqes-kundër diskriminimit dhe militarizmit

Në Tetovë, Ditët e paqes (ditë kundër diskriminimit dhe militarizmit) u shënuan me një ngjarje publike në sheshin e qytetit dhe me një debat në hotel Liraku. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim midis Multikulturës dhe Aksionit Paqësor– Prilep.

Të rinjtë, mbështetjen e tyre për një shoqëri paqësore e dhanë duke shkruar grafite dhe shpërndarë materiale promovuese, përderisa qytetarët nëpërmjet një peticioni simbolik dhanë nënshkrimet e tyre për të mbështetur paqen.



Vizita studentore nëpër qytete tjera në Maqedoni

Në kuadër të aktiviteteve, Multikultura organizon vizita studentore për vullnetarët e organizatës. Këto vizita kanë qëllime edukative dhe shpesh vizitohen qytete, të cilat kanë vlera kulturore, ose të paktën, organizata, me qëllim që të shkëmbehen përvojat në mes të rinjve. Këto vizita gjithashtu lejojnë edhe kohë për aktivitete të lira për vullnetarët, përmes të cilave ata shoqërohen dhe njihen ndërmjet veti.



Trajnim për trajnerë

Trajnimi për trajnerë paraqet aktivitetin kryesorë në programin tonë. Ky trajnim udhëhiqet nga trajnerë profesionalë, të cilët punojnë për NCBI- Zvicër. Qëllimi është që të rinjtë nëpërmjet një punëtorie treditore të trajnohen dhe të përdorin teknikat e NCBI për zgjidhjen e konflikteve dhe tejkalimin e stereotipeve dhe paragjytimeve. Trajnimi organizohet për 7 vite me radhë dhe prej tij dalin trajnerë të suksesshëm dhe të çertifikuar. Këta trajnerë, tash më janë në gjendje të mbajnë punëtori dhe njohuritë e fituara t'ua përcjellin studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme.



Vala e nxehtë kulturore

Bashkëpunimi i suksesshëm në mes OJQ Multikultura dhe Komunës së Tetovës më mirë shihet përmes aktiviteteve të organizuara në kuadër të projektit Valët e nxehta kulturore në Tetovë. Gjatë muajve të ngrohta, korrik dhe gusht, jeta kulturore në Tetovë pasurohet nëpërmjet shfaqjeve të filmave të ndryshëm, debateve publike dhe aktiviteteve tjera, të cilat në fokus e kanë kulturën.

Në këtë mënyrë, të rinjtë shprehin nevojat e tyre kulturore dhe krijojnë shprehje për të vizituar të këtyllat.



DITËT E NXEHTA KULTURORE 2011

22 Gusht 2011

14:00-15:30

Debatë: Dallimet kulturore në Tetovë

Vendi: Ndërtesa e vjetër e Radio Tetovës

Debatues: Katerina Mojancevska - Multimedia Shkup
Vullnet Zenki - Multikultura Tetovo

26 Gusht 2011

21:00-23:00

Shfaqja e filmit: Freedom Writers

Vendi: Para Copy Shop Figa

Komuna e Tetovës
NGO Multikultura
Ministria e Kulturës

www.multikultura.org.mk / www.tetovo.gov.mk

Работилници за надминување на предрасudi и стереотипи и мирно решавање на конфликти

Овие работилници се организираат и водат од страна на тренерите кои веќе го поминале тренингот и се запознале со техниките на NCBI, тие го пренесуваат своето знаење на студенти и средношколци преку симулирање на конфликтни ситуации.



Punëtori kreative me rastin e 8-Marsit

Në kuader të qëllimeve të saja strategjike, Multikultura punën e saj e drejton edhe ndaj më të rinjëve. Andaj, me rastin e Festës së Nënës, me datë 7 Mars 2012, në hapësirat e Multikulturës u organizua punëtori kreative me fëmijët e moshës parashkollore, të cilët kanë bërë kartolina me qëllim që dita e nënës të fesohet në mënyrë sa më kreative.

Rabije Musai



Punëtori të ndryshme për zhvillimin e kapaciteteve të OJQ Multikultura

Mbështetja nga ana e CIVICA Mobilitas do të thotë ndërtim i kapaciteteve, të cilat i posedon Multikultura. Përkatësisht, ky program mundëson trajnime dhe punëtori, në të cilat ekipi i organizatës mëson aftësi të reja dhe i përvetson ato aktualet. Deri tani, stafit të Multikulturës iu mundësuan punëtori të ndryshme si: punëtori për zhvillimin e planit strategjik, punëtori për shkrimin e dy propozim-projekteve të reja dhe punëtori për zhvillimin e strategjisë së PR-it. Të gjitha këto trajnime u mundësuan nga ana e ekspertëve në fushat e caktuara, dhe si rezultat i tyre, dolën dokumentet e realizuara, që paraqesin element të rëndësishëm për organizatën tonë.




Organizata joqeveritare Multikultura, në bashkëpunim me NCBI, Washington dhe me mbështetjen e Komunës së Tetovës, për të dytin vit rradhazi do të organizojë manifestimin "Dita e dallimeve". Ky manifestim vitin e kaluar është mbajtur në datë 25 Shkurt, përderisa këtë vit do të mbahet me datë 15 Maj.

Qëllimi i këtij manifestimi është që të kemi të paktën një ditë në vit ku të gjithë ne do të mund të bashkohemi, pavarësisht racës, religjionit, gjinisë, moshës, etnitetit dhe aftësive të kufizuara, dhe të përfaqësojmë veten tonë dhe gjërat e përbashkëta që i kemi. Kjo është ditë ku mund të reflektojmë dhe të mësojmë për kulturat dhe ideologjitë tjera.



Pjesëmarrësit në këtë manifestim janë njerëz nga profile të ndryshme, duke filluar nga vetë kryetari i komunës së Tetovës dhe stafi i tij, përfaqësues nga komuna e Gostivarit, Qendra e Karrierës (UEJL, USHT), nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme të Tetovës, organizatat tjera joqeveritare, mediumet lokale dhe ndërkombëtare, dhe të fundit por jo më pak të rëndësishmit, mysafirë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati i Arsimit.



Hapjen e këtij manifestimi do ta bëjnë nxënësit e shkollës së mesme të muzikës, Tetovë. Pastaj do të ketë promovim të talentëve të rinj, prezentim të ushqimeve tradicionale shqiptare, maqedone, turke dhe rome, ku të ftuarit do të kenë mundësinë t'i shijojnë ato. Manifestimi do të jetë i plotësuar edhe me valle tradicionale nga grupe profesionistësh të etniteteve të ndryshme dhe ekspozitë të pikturave të realizuara nga piktorë amater. Në kuadër të këtij aktiviteti, pjesëmarrës do të jenë edhe fëmijë me nevoja të veçanta nga Qendra ditore, Tetovë, të cilët gjithashtu do ti prezentojnë talentet e tyre.



OJQ-të, shkollat dhe universitetet, atë ditë do të mund të promovohen nëpërmjet materialeve të ndryshme promovuese në kuadër të shtan-deve, që do të jenë të rezervuara për ato.

I gjithë ky manifestim do të për-mbyllet me një mbrëmje argëtuese, për të cilën do të kujdeset grupi muzikor The Code.

E konsideroj si informatë të rëndë-sishme të ndaj me ju të dashur lexues, se biletat hyrëse për mbrëmjen do të ndahen gjatë gjithë organizimit, i cili do të mbahet para Qendrës për kulturë, Tetovë, dhe për këtë arsye ju kisha sugjeruar të vini dhe të na bashkangjiteni në këtë ditë kaq të madhe, ndryshe nga përditshmëria jonë.

Blerita Bexheti



Na tregoni më tepër për fëmijërinë tuaj, marrëdhëniet me motrat tjera, me Marinën, pasi që të dyja jeni fytyra publike?

L. Vjollca: (Qesh) sa herë më pyesin për fëmijërinë më vjen për të qeshur, kam qenë si djalë nga tipi, bëja shumë prapësina dhe, besoni ose jo, kam qenë tepër e shëndoshë (qesh), ndërsa për motrat di vetëm t'ju them që jemi një katërshe e pandarë. Me Marinën, natyrisht, jam më e lidhur se gjatë gjithë kohës jemi bashkë, në punë, në shkollë, kudo.

Si admiruese e kulturës dhe e artit, cilin libër do ta kishit veçuar?

L. Vjollca: Është "Idioti" i Dostojevskit.

A keni ndonjë vend të preferuar në Maqedoni?

L. Vjollca: –Po, kam disa, por s'i di me emra të saktë. Tetovën do vij shumë shpejt ta vizitoj, sepse deri më tani koha nuk më ka premtuar të vij atje. Shkupi, Ohri, Struga më pëlqejnë tepër.

Na tregoni diçka për ushqimin tuaj të preferuar (tradicional)

L. Vjollca: –Për ushqim jam pak speciale, mundem të ha gjithçka ama e gatuar vetëm nga mami im, ndërsa çka më pëlqejnë më shumë janë makaronat :)



Kush mendoni e ndjek modën më tepër tek shqiptarët, meshkujt apo femrat?

L. Vjollca: –Kohët e fundit po futet një frymë e re që edhe meshkujt sa vijnë edhe i shohim më tepër të kurrar, gjë që mua më pëlqen. Besoj varet nga njeriu, ndonëse femrat janë ato që kujdesen më tepër për këtë anë e me të drejtë :)

Ju keni filluar një karrierë që në moshë të herët, a ndiheni më ndryshe nga moshataret tuaj?

L. Vjollca: Ndihem me fat, është e vërtetë që tepër e vogël kam filluar me punë, dhe kjo ka ardhur tepër rastësisht. Më është dashur të lë pas dore shumë gjëra e qejfe të moshës sepse të gjitha nuk mund të bëhen. Por, kur marr gjithë këtë dashuri nga publiku i gjërë, atëherë them që me të vërtetë jam me fat :)

Ka ndonjë pasion Luana Vjollca?

L. Vjollca: Po, ama nuk dua akoma ta zbuloj :)

Keni ndonjë peng të parealizuar?

L. Vjollca: Hmm... besoj që po, ama derisa ta realizoj nuk dua as këtë ta zbuloj, ka lidhje me pasionin:)

Jeni prezantuese në "Top Fest", ndërkohë që jeni të angazhuara edhe me të tjera projekte. Si është të kesh kaq shumë gjëra për të bërë?

L. Vjollca: –Është përgjegjësi e madhe, sepse i tillë është vetë televizioni, do shumë punë, ka shumë lodhje por të sjell edhe kënaqësi të madhe!

"Top Fest" si po shkon? Sa komode ndiheni në prezantimin e këtij programi? Motin s'do ta lini ndonjëherë?

L. Vjollca: – "Top Fest" shkon top! Është format që na përshtatet, unë personalisht ndihem shumë komode në prezantimin e tij. Jam krejtësisht vetja në këtë program, sepse jam shumë e lidhur me muzikën dhe ato minuta çdo ditë, derisa jemi në transmetim i shijoj në maksimum. Ndërsa moti është diçka tjetër, më vendos më tepër në kontakt me publikun edhe kjo më bën mos ta lë asnjëherë.

Sa e vështirë është të jesh pjesë e "Top Channel"?

L. Vjollca: –Më mirë do të ishte, sa bukur është të jesh pjesë e "Top Channel".

Arlinda Mazllami

Ballkani si metaforë


(Mbi librin **Ballkani imagjinar** nga Maria Todorova)

Libri “Ballkani Imagjinar” (Imagining the Balkans) i studiueses bullgare Maria Todorova, i shkruar në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX, konsiderohet njëri prej librave më të mirë mbi gadishullin tonë. Libri u botua, sikurse thuhet, në kohën kur Evropa Juglindore ishte në qendër të vëmendjes së përgjithshme, pas intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi, tanimë të shpërbërë (verë 1999). Bashkësia ndërkombëtare, pas këtij intervenimi që i dha fund dominimit të një regjimi luftënxitës, nëpërmjet Paktit të Stabilitetit të Evropës Juglindore, bëri tentimin domethënës për një formësim të ri politik të rajonit me qëllimin që ta integronte në Bashkësinë Evropiane.

Libri u botua në kohën kur evropianët vazhdonin që ta shihnin Gadishullin si rajon pikëpresjesh të qytetërimeve dhe kulturave tëndryshme; me mentalitet të

ndryshëm nga pjesa tjetër e Evropës: si “fuqi baruti”. Pra nëpërmjet një thjerrëze paragjyimesh të vjetra. Autorja sfidon stereotipat të pranishëm edhe në qarqe diplomatike dhe akademike evropiane. Nën thjerrëzën e botëshikimit të saj, Gadishulli “nuk është as më i mirë, as më i keq”, por një rajon i paragjykuar nga pjesa tjetër evropiane. Rrënjët e këtyre paragjyimeve, sipas saj, duhet kërkuar nga koha e shthurjes së Perandorisë Osmane, nga vrasjet politike, luftërat ballkanike (njëra e konsideruar si gjenocid, kurse tjetra si fratricid), atentati i Sarajevës etj.

Trazimet e këtilla politike dhe historike, sipas studiuesit Boris Buden, u shfrytëzuan nga mediat e atëhershme evropiane për të krijuar një imazh negativ mbi rajonin, si një hapësirë gjeografike ku jeta shoqërore, politike dhe kulturore nuk kishte pikëtakime me standardet e




botës së ashtuquajtur qytetëruese.

Paragjykimet e këtilla krijuan imazhin për Gadishullin si një vend “barbar”, “primitiv”, “jotolerant”, “të brishtë”, “të paparashikueshëm”, “diçka tjetër”, “pjesë e errët e Europës”. Paragjykimet e këtilla sfidohen nga Todorova. Ajo në mënyrë shkencore, duke shfrytëzuar burime të shumta historike, publicistike, akademike, kundërshton pohimet e këtilla. Nëpërmjet librit, me një bibliografi të gjerë dhe me shumë referenca prej studimesh të ndryshme të autorëve të njohur ballkanas, në mesin e të cilëve edhe shqiptarë, Todorova hedh poshtë tezat se luftërat dhe dhuna në Ballkan janë pasojë e një instinkti të lindur të ballkanasve. Plasaritjet e thella, sipas saj, ishin pasojë rrethanash të caktuara historike, prandaj dhe ftesa e saj humane për të ndryshuar botëshikim mbi Gadishullin, ku jo gjithçka është “zi e më zi”.

Studiuesit, që i janë referuar librit të Todorovës, thonë se ajo është autorja e lindur për të shkruar një libër të këtillë sepse: ka prejardhje nga Ballkani (Bullgaria), pra e njej mirë atë; është shkencëtare e veçantë që shërbehet me burime nga shumë gjuhë dhe, më e rëndësishmja, e do atë.

Në libër ka referenca historike, publicistike, antropologjike, politike, gjeografike. Ka kundërshtime ndaj tezave që e paraqesin Ballkanin si “variant orient”. Termi “orient”, sipas saj është amorf dhe



Ballkani si metaforë (Mbi librin *Ballkani imagjinar* nga Maria Todorova)



nuk vlen për Ballkanin, i cili ka ekzistencë konkrete historike, i formësuar si pasojë e ngjarjeve të shumta, interesave të ndryshme, proceseve që kanë ndodhur përgjatë shekujve etj.

Përkundër vlerësimeve të shumta mbi librin, i cili është bërë preferencial për studiuesit e shumtë, autorja e konsideron atë si gërvishtje në sipërfaqe të Ballkanit.

Ajo ka thënë se Ballkani është metaforë: “Në fillim të shekullit XX ishte term pezhorativ, por ky është proces i shkallëzuar, i kushtëzuar nga ngjarjet që lidhen me shpërbërjen e Perandorisë Otomane dhe lindjen e shteteve të varura kombëtare dhe të dobëta ekonomikisht që pretendojnë të modernizohen”.

Ballkani u bë simbol agresiviteti, barbarie, mungese të tolerancës, u quajt si rajon me zhvillim të mangët, më pak të qytetëruar, gjysmë

oriental, për shkak të pengesave në modernizimin e tij.

Së këndejmi, duke e kritikuar këtë keqpërdorim nga ana e qarqeve intelektuale dhe politike evropiane, shpreh besimin se Gadishulli mund të jetë metaforë e së mirës, mund të jetë sinonim i pavarësisë, i liridashjes, i trimërisë, i krenarisë dhe vend frymëzues për poezi e prozë ekzaltuese, sikurse ndodhi në shekullin e XIX-të.

Le të përkujtojmë se në mesin e popujve të Ballkanit kemi shumë krijues, artistë, që i dhanë shumë vlera të përbotshme sistemit kulturor evropian.

Todorova konsideron se që të flitet për Ballkanin duhet paraprakisht të njihet mirë dhe këtë mund ta bëjnë pikërisht studiuesit ballkanas. Kështu vepron edhe autorja, e cila, nëpërmjet këtij libri, paraqet imazhin tjetër të tij – anën pozitive.

Ballkani (një emërtim më i vonshëm), si i tillë, mund të jetë modeli për popujt e tij për të shprehur vetveten ndryshe nga çfarë i shohin të tjerët – duke i paragjykuar, duke i shikuar habitshëm dhe duke mos i njohur thellësisht.

Salajdin Salihu

Çka është PR? Imazh, besim dhe marketing

Një kompani pa PR është sikurse një mashkull që i`a bën me sy një vajze shumë të bukur, në errësirë. Vetëm ai e di se çka po bën, askush tjetër.



Sipas Gill Mears, ekspert i Wessex Public Relations, PR-i është një fotografi, reputacion, besueshmëri dhe marketing për një biznes apo një kompani. Ai thotë: "PR është një pjesë thelbësore e çdo organizate moderne, pa marrë parasysh madhësinë (qoftë ajo një organizatë e madhe apo e vogël), i cili kontribuon për të arritur qëllimet e kësaj organizate dhe mbi të gjitha për të fituar emër". Një kompani pa PR është sikurse një mashkull që i`a bën me sy një vajze shumë të bukur, në errësirë. Vetëm ai e di se çka po bën, askush tjetër.

Unë mendoj që një organizatë për të arritur qëllimet e veta dhe për të ruajtur reputacionin që ka, një sektor i PR-it është shumë i nevojshëm për të. Unë kam shumë argumente, por do përmend vetëm disa:

Bota e biznesit sot është jashtëzakonisht shumë garuese. Kompanitë duhet të kenë një anë (kënd) që i bën ato të dallueshme nga turma, diçka që i bën ato më të dukshme dhe më interesante, bashkë për

publikun dhe për median. Publiku është ai që e blen produktin, kurse media është për-gjegjëse për t`a shitur atë. Për shembull, ka shumë kompani që prodhojnë pije freskuese po pse zakonisht njerëzit përdorin Coca Cola? Sepse kjo kompani harxhon një shumë të madhe parash për marketing dhe PR, dhe thjesht tash ka krijuar emër dhe njihet tek audiencia.

PR siguron një shërbim për kompaninë duke e ndihmuar atë për t`i dhënë publikut dhe medias një kuptim më të mirë për mënyrën se si funksionon kjo kompani. Në një kompani, PR-i gjithashtu mund të jetë një informacion për publikun ose marrëdhënie me klientin.

Ky departament është shumë i nevojshëm sepse tregon më të mirën e kompanisë. Për shembull, kemi blerë një numër telefoni nga kompania T-Mobile dhe nuk dimë ta përdorim atë. Fatmirësisht kjo kompani ka një sektor që kujdeset për shërbimin me klientët (siç është PR), i cili na jep të gjitha instruksionet e përdorimit.

PR i jep mundësinë kompanisë që të organizojë evente speciale me anë të të cilave e rrit dukshmërinë e saj. Jo çdo kompani organizon kampanja të ndryshme, bën oferta dhe promocione të ndryshme vetëm e vetëm që të fitoj sa më tepër klientë. Të gjitha këto organizohen nga sektorët e PR-it. Të marrim shembullin e kompanisë Avon, një kompani për kozmetikë e cila bën të pamundurën vetëm për të shitur produktet e saja. Bën oferta dhe promocione të ndryshme, madje organizon mbrëmje të ndryshme ku jepen edhe produkte falas.

Si përfundim dua të them se sot kompanitë nuk mund të ekzistojnë pa ekspertë të PR-it. PR është shumë i rëndësishëm, dhe të jesh në gjendje ta përdorësh atë në mënyrën e duhur do të thotë shumë, sepse në një farë mënyrë suksesi duhet të nxirret në treg.

Arlinda Mazllami



Mësova të shikoj botën me sy fëmijësh

Është ndjenjë e bukur puna me fëmijët. Kulminacionin e satisfacionit shpirtëror e arrin kur depërton thellë në psikologjinë e tyre dhe kur je në gjendje të mëtos mënyrën se si përdorin intelektin për vendimmarrje. Fëmija është aq i çiltër dhe syhapur njëkohësisht.

Unë kam pasur kënaqësinë që në kuadër të bashkëpunimit të organizatës joqeveritare "Multikultura" dhe ekuivalenti "Sonce" të thith monjën e humanizmit dhe zemërgjerësisë së shpirtit duke kontribuar në përmirësimin e shtegut në të cilin shkollohen fëmijët romë.

Para së gjithash një tutorim të kësaj natyre e ndjej si shlyerje të borxhit moral për një kategori, e cila ka qenë tradicionalisht e diskriminuar. A ka ndjenjë më të bukur se të ofrojmë mundësi të njohim më mirë njëri-tjetrin nëpërmes mësimin dhe lojës?



Një projekt i këtillë demaskon faktin që jemi aq të ndryshëm. Pa mëdyshje që ne jemi të njëjlojtë.

Nga puna me fëmijët mësora shumë dhe ajo që mund të veçoj si përvojë të mirë është shikimi i botës nga këndvështrimi fëmijëror pa stereotipa dhe pa paragjykimë. Fëmijëve u ndihmova që me lehtësi të bëjnë kërcimet e para ndërsa si dhuratë fitova buzëqeshje dhe mirënjohje të singertë.

Nita Kaprolli

Vlera rrezatuese

Ferid Murat, Luan Bexheti, Blerim Destani, janë disa nga emrat e shquar që reflektojnë përtej hapësirës shqiptare

Njeriu në jetë vlerësohet dhe respektohet për bëmat dhe të mirat që ka bërë, ajo e ngrit, e pasuron dhe e mvesh me vlerat më të larta të njerëzimit. Populli shqiptar ka një histori të lashtë. Historia ka filluar të datojë qysh nga koha e paraardhësve tanë që kanë qenë Pellazgët, dhe vazhdon edhe në ditët e sotme. Emra të shquar të shqiptarëve që përmenden anë e mbanë botës ka shumë, disa prej tyre kanë vepruar dhe kanë jetuar në vendlindje, kurse disa prej tyre jashtë. Të tillë që kanë jetuar, vepruar dhe arritur suksese të mëdhaja jashtë vendit ka shumë, por në vijim janë të përshkruar disa biografi të shkurtëra të disa prej tyre:

Luan Bexheti

Halil Luan Bexheti lindi më 11 gusht 1971, në fshatin Odër të Tetovës. Në vitin 1976, kur ai ishte vetëm 4 vjeç familja e tij vendosën që të shpërngulen për në Oslo të Norvegjisë nga shkakut se babai i tij do të punonte atje si mësimsdhënës.

Familja Bexheti ende jeton në Oslo, ku janë pronarë të disa klubeve.

Pas mbarimit të shkollimit, Luani vendos që të shpërngulet në Amerikë për të studiuar në institutin e njohur të New York–ut “Lee Strasberg Theatre”, dhe për të ndjekur një karrierë në aktrim dhe prodhim të filmave.

Deri më tani, ai ka punuar në 41 filma të pavarur, 12 reklama dhe 29 këngë. Ai poashtu ka punuar edhe me Michael Moore, në një shfaqje të quajtur “Michael Moore Live”.

Pati rolin kryesor në filmin “Maree” që u xhirua në Venedik, Itali dhe poashtu ky film u shfaq në 96 festivale të ndryshme nëpër botë. Luan Bexheti është edhe producent (regjisor). Projekti i tij i fundit është “Cadillac Man” (King of lost souls) që është i drejtuar nga Michael Regan. “Cadillac”, është një film dokumentar për një veteran të pastrehë; poashtu është bërë edhe një marrëveshje me një shtëpi botuese amerikane që të botohet edhe si libër.

Luan Bexheti kohën e tij e kalon në SHBA, Norvegji dhe në Maqedoni.



Blerim Destani lindi më 12 prill 1981 në Stolberg të Gjermanisë. Fëmijërinë e tij e kaloi në Tetovë. Dhjetë vitet e fundit ai jeton dhe vepron në Maqedoni dhe Gjermani.

Blerimi, pasionin për aktrim e zbuloi që në moshë të re. I plotë me ambicje ai ka ndjekur qëllimin e tij, duke ia përkushtuar kohën dhe energjinë temave të filmit dhe regjisë.

Në moshën 14 vjeçare ai bëri debutimin e tij duke luajtur në filmin televiziv shqiptar “Atje ku nuk lind dielli” dhe po në atë moshë filloi të ndjek dhe mësimet aktrimit në Angli.

Në vitin 2004 Blerimi Destanit iu ofrua roli i tij i parë i madh në një film. Ai tërhoqi vëmendjen e konsiderueshme të publikut në Evropën Juglindore duke luajtur rolin kryesorë “Beni” në produksionin televiziv kosovar “Metropolet” (me drejtor, Sunaj Raça).

Drama “Metropolet” trajton fatin e djalit të ri shqiptar Benit, i cili shpreson të përmirësoj gjendjen e tij financiare brenda një kohe të shkurtër në Gjermani. Për të arritur këtë qëllim ai braktis familjen dhe miqtë, dhe lidhet me gangsterin Musa. Megjithatë, plani nuk funksionon dhe Beni përfundon në burg, dënohet me disa vite burgim dhe e kupton se nuk është aq lehtë për të lënë të kaluarën prapa.

Bashkëpunimi i suksesshëm me drejtorin e njohur Sunaj Raça u vazhdu në vitin 2005 me filmin “Kosova– Desperate Search”. Filmi tregon pasojat dhe ndikimet e luftës së Kosovës në popullsinë shqiptare. Spastrimet etnike dhe disa faktorë të tjerë, psikikisht dhe fizikisht shkatërruan

SHQIPTARË TË SHQUAR

Vlera rrezatuese

popullin shqiptar. Fatet e ndërthurrura të personave dhe familjeve nga rajonet e ndryshme gjeografike dhe klasat e ndryshme sociale janë baza për një histori të ndërlidhur ngushtë. Familjet, jo vetëm që kërkojnë fëmijët e tyre të humbur, por edhe për një perspektivë dhe shpresë të re.

Në këtë film, Blerimi, shumë mbreslënës e sjell karakterin kompleks të një njeriu që ka nevojë për të provuar cilësitë e tij si ushtarë, burrë dhe baba.

Sidoqoftë, Blerimi nuk është vetëm aktor, ai ka interes të gjërë në të gjitha aspektet e filmografisë, dhe ka fituar përvojë të madhe në fushën e regjimit dhe produksionit. Ai ishte producent i produksionit të suksesshëm kinematografik të Maqedonisë “The Great Water” (i drejtuar nga Ivo Trajkov) i xhiruar në vitin 2004. Në vitin 2005, u shfaq në shumë festivale dhe mori një numër të madh çmimesh.

Blerim Destani aktualisht është duke vazhduar trajnimin e tij për të qenë një aktor i suksesshëm duke marrë mësim për oratori, në mënyrë që ti përmirësoj aftësitë e tij dhe të përgaditet për projektet e reja ndërkombëtare të filmit.

Ferid Murad

Ka lindur më 14 shtator 1936, në Whiting Indiana. Djalë i Xhabir Murat Ejupi, një musliman shqiptar nga Gostivari dhe Henrieta Bowman, një krishtere amerikane.

Ai mori diplomën e tij universitare në kimi prej programit pre-med në universitetin De Pauw në vitin 1958, poashtu diplomon edhe për farmakologji Ph.D. në universitetin Western Reserve në vitin 1965, një diplomë të hershme nga programi i parë i trajnimit mjekësor. Më vonë iu bashkangjiti universitetit të Virgjinisë, ku në vitin 1970 u bë profesor, para se të shpërngulej për në Stanford në vitin 1981.

F. Muradi la qëndrimin e tij në Stanford në vitin 1988 për një pozitë në laboratorin Abbott, ku atje shërbeu si zëvendës president, deri sa filloi me punë në kompaninë e tij bioteknologjike “The Molecular Geriatrics Corporation” në vitin 1993. Kompania përjetoi vështirësi financiare, dhe në vitin 1997 Ferid Murad u bashkua me Universitetin e Teksasit për të krijuar një departament të ri të biologjisë integruese, farmakologjisë dhe fiziologjisë. Këtu ai ishte profesor dhe drejtor i institutit të fondacionit Brown të mjekësisë molekulare për parandalimin e sëmundjeve njerëzore duke u mbajtur në nder të S.Dunn Distinguished Chair në filozofi dhe mjekësi.

Në vitin 2011 ai u shpërngul për në Universitetin George Washington, ku punoi si profesor i Biokimisë dhe Biologjisë Molekulare. Hulumtimi kyç i Muradit tregoi se nitroglicerini dhe droga të ngjajshme, funksiononin duke liruar oksid nitrik në organizëm, i cili vepron si një molekulë e sinjalizimit në sistemin kardiovaskular duke i stimuluar enët e gjakut të zgjerohen. Hapat që mungonin në procesin e sinjalizimit i plotësuan Robert F. Furchgott dhe Luis Ignarro, dhe të tre e ndanë çmimin Nobel në vitin 1998 (për të cilin F. Muradi dhe R. Furchott morën çmimin Albert Lasker për Kërkime Bazë në Mjeksi).

Sot për nderë të tij, spitali në qytetin e Gostivarit mban emrin “Ferid Murad”.

Çdokush mund të heqë dorë, është gjëja më e lehtë në botë... Por të rrezistosh kur të gjithë të tjerët presën të biesh për tokë, kjo është forca e vërtetë!



Selima Shaqiri



Koha e vetme ku mundësitë e pasurimit gjuhësor, shkencor, oratorik janë të shumta, madje “nuk kanë fund”.

Qeshu rini, qeshu, bota është e jotja (kështu fliste Migjeni)!

Njeriu në jetën e tij sfidon gjithçka, bën gjithçka vetëm e vetëm të arrijë të një pikë, e cila sado pak siguron një të ardhme të largët. Kështu është edhe studenti. Ai duhet të ketë një vizion, duhet ta plotësojë zbrazëtirën midis asaj që është dhe pretendon të jetë. Ai duhet të ketë një plan B!

Jeta studentore dallon prej momenteve të ndryshme, jo vetëm se është e bukur, por është edhe shumë interesante dhe shumë praktike. Kjo është e vetmja kohë ku mundësitë e pasurimit gjuhësor, shkencor, oratorik janë të shumta, madje “nuk kanë fund”. Nga një këndvështrim tjetër ka edhe prej atyre, të cilët lexojnë vetëm për ta kaluar kohën, por këto i urrente edhe Zaratustra të vepra e filozofit më të shquar gjerman Friedrich Nietzsche. Shekulli XXI, është diçka më ndryshe tani, posaçërisht viti 2012, ku është shfaqur një konkurrencë jolojale, e pamëshirshme! Por e gjitha kjo është normale, sepse kanë ndryshuar

kohërat, njerëzit, mënyra e të jetuarit, shumë pak do të vlen të parimi i famshëm “Peshku i madh e ha të voglin”, në botën moderne është “Peshku i shpejtë e ha të ngadalshmin “Studenti duhet të jetë i përqëndruar vetëm në përfitim të dijes dhe mësimin sistematik, kështu do të korrë sukses të garantuar. Këto vite do ti quaja si vitet e arta, sepse këtu ngërthehen në vete shumë gjëra fitimprurëse dhe pragmatike.

Studenti duhet të sakrifikojë gjithçka. Është shumë normale se do të ketë edhe vështërsi, por siç thonë të vjetrit, në vështërsi qëndron lumturia!

Ka shumë studentë, të cilët janë të dhënë pas qejfeve, pas argëtimit të ndryshme, pas lojrave të fatit, ahengjeve mbresëlënëse, e dikush ndikohet nga presionet e rretheve të ngushta, posaçërisht nga prindërit, të cilët kërkojnë me çdo kusht mesatarja të jetë e lartë. E gjithë kjo ndodh sepse ata “paguajnë”, por presionet janë të lehta dhe pranohen, sepse nuk është më ajo koha e muzikantëve klasik botërorë, kur Beethoveni e

vinte kokën në ujë të ftohtë për të mos e zënë gjumi, e me këtë i humbi edhe shqisat e dëgjimit.

Në kohën tonë, e gjithë kjo duket e pabesueshme, sepse s’e kemi parë, veç e kemi dëgjuar ...

Njerëzit që kanë kaluar nëpër eksperiencën të ndryshme, dijnë të tregojnë për atë se si duhet të duket një student, si të jetë i kompletuar dhe me çfarë hapa duhet të ecë, sepse në fund të fundit studenti është i vetëdijshëm se si do ta proektojë jetën në të ardhmen.

Gjëja më e rëndësishme për studentin është vullneti i fortë, ai atëherë arrin gjithçka. I.Hordshek thoshte: Njeriu është i madh vetëm kur mëson se vërtet është shumë i vogël.

Koha jonë është e bukur, studenti optimist beson se kjo është koha më e mirë për të jetuar, e ai pesimisti frikësohet mos ndoshta kjo është e vërtetë ...

Arlind Qamili

Familja si shpëtim

“Motrat” nga Danielle Steel, një orientim për t'u mbështetur te familja, atëherë kur ndjehemi keq dhe të braktisur nga gjithkush

Për të gjithë ata që i duan veprat e Danielle Steel, ky është libri që duhet ta lexoni. Libri përmban tregimin për dashurinë e katër motrave, i cili për një moment ua ndryshon jetën. Në këtë libër shkrimtarja na njofton me katër motra, të cilat i përkushtohen krejtësisht karrierës së tyre dhe nuk gjejnë kohë të mjaftueshme për t'u shoqëruar në mes veti, përveç disa festave, kur mbildhet e gjithë familja në shtëpi.

Do t'ju njoftoj me heroinat kryesore të këtij tregimi, Kendi është më e vogla dhe e jeton jetën në botën e ëndrrave. Ajo është model i suksesit dhe jeton në luks. Tami është e preokupuar me karrierën e saj dhe shumë vështirë gjen kohë të lire. Është producente e filmave serik hollywoodian dhe jeton në Los Angeles. Tjetra është Eni, më e mençura e familjes. Ajo jeton në Firencë. Edhe pse është larg motrave të saj, çuditërisht është e lidhur ngushtë me ato. Më e vjetra prej tyre është Sabrina, e vetmja, e cila ka lidhje serioze me Krisin, por

përsëri frikësohet të fejojë me të. Jeton në New York dhe punon si avokate.

Gjatë një takimi familjar, derisa të gjithë kënaqeshin dhe i kthenin kujtimet, ndodhi tragjedia, një aksident rrugor, që i ndau motrat nga gjiri familjar, nga nëna. Eni ishte ajo që humbi shumë, humbi shikimin. Kjo tragjedi simbolizon kthesë në jetën e katër motrave. Në këto momente ata treguan humanitetin e tyre, të trija sakrifikuuan diçka për ti ndihmuar motrës së vogël.

Kjo dramë e ngrohtë familjare, do t'ju afrojë në pasuritë familjare, do t'ju tregojë se lidhjet familjare janë më të forta nga gjithçka e mbetur dhe vetëm te familja mund të mbështeten kur ndjeheni keq dhe të gjithë kanë ikur.

Hristina Vasilievka

Tres metros sobre el cielo

Viti i prodhimit: 2010

Regjisori: Fernando Gonzales Molina

Personazhët:

Mario Casas, Maria Valverde

Zhanri: Dramë, Romansë

Kohëzgjatja: 119 minuta

„Tres metros sobre el cielo“ është një film spanjoll që do t'ju lejë pa frymë dhe do t'ju kaplojë me emocione. Nëpërmjet kësaj drame shumë njerëz të rinj mësuan si duhet të luftojnë për dashurinë e tyre edhe pse prindërit janë kundër dhe ushtrojnë diskriminim klasik mbi partnerin e tyre.

Tema kryesore e këtij filmi është dashuria e dy të rinjve dhe shikimet e tyre të ndryshme ndaj botës. Mario Casas (Hache) është një djalë i ri rebel, i cili në rininë e tij ka përjetuar traumë të madhe, që ia ka ndryshuar jetën. Derisa, Maria Valverde (Babi) është një vajzë nga një familje e pashme, e cila pothuajse gjithë jetën ia përkushton mësimit.

Këto dy personazhe, të cilët janë dukshëm të ndryshëm, do t'i bashkojë një dashuri e papritur. Por aty është nëna e Babi-t, e cila do të jetë kundër kësaj lidhjeje sepse Hache-ja nuk është i përshtatshëm për vajzën e saj. Rrëfimi është entuziasmues, dinamik dhe emocionues, dhe me siguri do t'ua merr frymën.

Deri në fund ndodhin shumë ngatërresa të papritura tek të cilat sytë do ti keni të mbushura me lot. Kritikant e mira vetëm e përdëftojnë kualitetin e këtij filmi, a që të jetë rrëfimi i plotë është shpallur vazhdimi i dytë i „Tres metros sobre el cielo“, i cili do ta ketë premierën më 22 Qershor të këtij viti. Ky rrëfim dramatik do t'ju jep forca dhe do t'ju mësojë si të luftoni kundër çdo lloji diskriminimi, për një jetë më të bukur dhe më të mirë.

Gorica Vasilevska



Diabeti, kjo sëmundje e shekullit

Ushqimi jo adekuat, mbipesha, përdorimi i tepërt i yndyrave dhe shkaqe tjera, janë faktorë që shpijnë drejtë paraqitjes së diabetit

Diabeti apo siç njihet ndryshe sëmundja e sheqerit, paraqet rritjen e sasisë së sheqerit në gjak, si rezultat i mungesës së sekretimit të hormonit insulinë që tajohet nga pankreasi.

Ekzistojnë dy tipe të diabetit :

- Diabeti i tipit 1 – ku përfshihen personat, të cilët nuk prodhojnë insulinë, dhe
- Diabeti i tipit 2 – ku përfshihen personat tek të cilët insulina merret si mundësi e fundit.

Ndryshe, kjo dukuri mund të quhet edhe si një sëmundje moderne, duke u bazuar në statistikat, të cilat tregojnë për një rritje të vazhdueshme të personave të prekur nga ky fenomen, prej ku vetëm në Shqipëri janë diagnostifikuar 45 mijë diabetikë.

Kjo rritje enorme e kësaj sëmundje, ka shqetësuar shumë mjekët, të cilët menjëherë kanë filluar të bëjnë kërkime në gjetjen e shkaqeve të saj, mirëpo mund të

thuhet se të njëjtat ende nuk janë zbuluar saktësisht. Andaj, ky fenomen vazhdon të mbetet një sindromë X.

Duke u bazuar në eksperimentet e bëra, mjekët konstatuan disa dukuri që mendohet se shpiejnë drejtë diabetit. Sipas tyre, grupmoshat 40–60 vjeçarë rrezikohen më tepër, si rezultat i mungesës së aktiviteteve fizike, që është një ndër faktorët kyç për shëndetin. Ushqimi jo adekuat, mbipesha, përdorimi i tepërt i yndyrave, e shumë shkaqe tjera, përmenden si faktorë që shpiejnë drejtë paraqitjes së diabetit.

Vlen të përmendet studimi që është bërë nga 1.240 pjesëmarrës, të cilët kanë treguar se pagjumësia kishte ndikuar në rritjen e sasisë së sheqerit në gjak, pamvarësisht nga mosha, gjinia, pesha, mënyra e të ushqyerit, gjë që n'a bën të kuptojmë se të gjithë në rrezikohemi nga diabeti.

Kjo sëmundje shkakton edhe

shumë dëmtime tjera në organizëm, duke filluar nga ato nervore, vaskulare, dëmtimin e syve, veshkëve dhe shumë të tjera. Disa nga simptomat e diabetit, të cilët mundemi ti vërejmë janë: fillojmë të hamë shumë, gjithashtu kemi raste kur fillojmë të humbim në peshë, kemi shumë etje, mvarësisht nga tipi i diabetit, urinojmë shpesh dhe ndjehemi tepër të stresuar.

Për ta parandaluar këtë fenomen, rekomandohet që t'ju largohemi ushqimeve të yndyrshme, që janë tepër të dëmshme; pijeve me kafeinë, të cilat e dyfishojnë rrezikun e diabetit; të përdorim sa më tepër zarzavate dhe njëkohësisht të merremi edhe me aktivitete fizike si p.sh. ecje të paktën 1 orë në ditë dhe kjo do të na ndihmojë shumë për t'u mbrojtur nga shfaqja e saj dhe për më tepër në atë që medikamentet të jenë zgjidhja jonë e fundit.

Xhemile Ameti



Pemë dhe perime për organizëm të shëndetshëm

Pemët dhe perimet na mbrojnë nga sëmundje të ndryshme kardiovaskulare, kanceri, sëmundje të sheqerit (diabeti)

Pemët dhe perimet janë pjesë e jetës tonë të përditshme. Pemët dhe perimet e freskëta janë të përbëra nga qeliza që marrin pjesë në veprimtarinë e vazhdueshme metabolike dhe në qoftë se një pemë, p.sh. një mollë, e cila përmban qeliza të këtitilla, e humbën freskinë ose gjatë pjekjes së saj, vjen deri te humbja e këtyre qelizave të rëndësishme.

Këto qeliza që ndodhen tek pemët dhe perimet lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet murit qelizor, kështu që na mbrojnë nga sëmundje të ndryshme kardiovaskulare, si kanceri, sëmundja e sheqerit (diabeti).

Te perimet kemi ndryshime të konsiderueshme të materieve ushqyese, p.sh. karrota, patatja dhe spinaqi përmbajnë kryesisht vitamin A, si dhe Beta-Karotin që paraqet antioksidant (substancë që ruan freskinë, ngjyrën e pemëve dhe perimeve). Ndërsa, perimet si: lakra, domatja, dhe speci përmbajnë vitamin C në përbërje të tyre. Perimet që përmbajnë karbohidrate janë të pasura me acid folik (ose ndryshe e njohur si vitamin B9). Shembull i saj është bizelja e freskët.

Pemët poashtu përmbajnë në sasi të madhe vitamina, dhe kryesisht vitamina A dhe C. Të pasur me vitamin C janë: agrumet (limoni, portokalli, mandarina), shalqiri, pjeperi, dredhëza; ndërsa pemët e pasura me vitamin A janë: kajsia, pjeshka, pjeperi, e te tjerë. Pemët që përmbajnë levozhgë në përbërje të tyre kanë potasjum (kalium) dhe acid folik (vitamin B9).

Pra, nuk duhet harruar edhe vlerën e vitaminave, të cilët janë me rëndësi jetësore. Ato marrin pjesë në funksione të shumta në organizëm edhe pse nuk kanë kalori.

Në fund duhet përmendur që, për shëndetin tuaj duhet medoemos:

- Të konsumohet gjellë pemësh dhe sallate sa më shumë;
- Kryesisht të konsumohen, pemë që përmbajnë vitamin C

Merve Arifi



Të dhënë pas Fc Barcelonës!

Një univers, 9 planete, 204 shtete, 809 ishuj dhe mbi 7 bilion njerëz, gërshetohen aktivitete të çuditshme dhe eufori të fuqishme, në këtë rast sportive!

Nga e gjithë kjo një pjesë përbën sporti, respektivisht futbolla spanjoll, FC Barcelona si ekipi më i popullarizuar dhe më i shikuar në rruzullin tokësor.

Është shumë normale për një klub të njohur futbollistik të ketë fansa të flaktë dhe brohoritje të fuqishme në shenjë të një përkrahjeje masive dhe "shpirtërore". Dikujt i duket absurde se si një shqiptar aq fuqishëm i simpatizon katalonasit, e sidomos klubin e Barcelonës, sipas dikujt asgjë nuk i lidh shqiptarët me këto, por përgjegjja është shumë faktike. Hasta la Vista! Është libër i njohur i Petro Markos. Një libër ku tregon shumë qartë senë luftën e Spanjës kanë marrë pjesë edhe shqiptarë. Është dallim i

madh midis luftës dhe sportit, por sido që të jetë edhe në sport ka një lloj lufte, lufta për fitore, luftë për t'i kënaqur fansat. Ndoshta ka edhe gjëra të tjera që i lidhin shqiptarët me spanjollët, madje mund të mos ketë aspak!

Barcelona, më së shumti njihet si klub futbollistik, i cili u themelua në vitin 1899 nga një grup zviceranësh, anglezësh dhe katalonezësh, në krye me Joan Gamper. Klubi u bë institut katalonez duke i vënë dhe moton Més que un club (Më shumë se klub).


Barcelona ishte anëtare themeluese e ligës spanjolle La Liga në vitin 1928 dhe së bashku me ekipet Madrid dhe Athletic Bilbao asnjëherë nuk kanë qenë të larguara nga liga e parë. Klubi gjithashtu ishte klubi i parë kampion i ligës Spanjolle duke fituar gjithësej 20 herë La Liga, 25 herë Kupën e Spanjës, 8 herë Superkupën e

Spanjës, 2 herë Kupën e Ligës së Spanjës, 3 herë Ligën e Kampionëve, 4 herë UEFA Kupën e Fituesve të Kupave, 3 herë Fair Cup, 3 Super Kupa Evropiane, 1 herë Kampionatin Botëror për Klube, 2 herë Kupën Latine, 4 herë kupën e Pirinejve, 1 herë ligën Mesdhetare, 1 herë ligën Katalane, 23 herë Kampionatin e Katalonisë dhe 6 herë kupën e Katalonisë.

Historiku i këtij ekipi është shumë i gjatë dhe sigurisht do të merr kohë për ta lexuar. Mjafton të njiheni me disa të dhëna që nuk i ka shpikur dikush, por që janë fakte dhe bazohen në sukses. Përveç suksesve ky ekip, si gjithë ekipet tjera, ka edhe mospusuese apo dështi-me. Një gjë duhet ditur, mundësisht edhe mbajtur mend se: ka humbje që vlejnë më shumë se fitoret! Nuk qahet në çdo humbje me gabime naive.. Nuk do të ishte interesante gjithmonë të jesh i pari.. Asgjë nuk zgjat përgjithmonë...

Arlind Qamili



	KOMBËTAR- JA E FUTBOLLI- STËVE NË FOTO	QË ESHTË SHUMË E KËRKUAR	MONEDHA ITALIANE PARA EUROS	PLOGËSHTI	ELEMENT KIMIK (Ti)							KREMI	SIMPATIZUE- SET E INTERIT	VEGËL E MJEKUT (shq.)	NJË PLANET I SISTEMIT DIELLOR (shq.)	GUENDJE PA PUSHTET	
MASHKULLI I PULES (sh. shq.)																RRUGË E PO- SACME PER GARA VRAP- MI, VRAPORE (shq.)	
SKUADRA, TIMI																SHKRIMTARI YNË PASHKU	
ZALL (sh. shq.)																SHKOPI I BILARDOS	
KRIFSHË (sh. pashq.)																NJË GRADË USHTARAKE	
ELEMENT KIMIK (Ac)																AUTOMJET RUMUN	KALIUM LLOJ XEHERORI
NATIONAL URBAN ALLIANCE				DËSHMORI YNË RIZA	SHTETI FEDERAL INDIAN ...PRADESH	KELVIN	PJESË E MURIT TË DRITAREVE (shq.)	SABEDIN (dim.)	PROGRAM	OKLAHOMA	NJË GJYMYTËRE E TRUPIT TË NJERIUT (sh. pashq.)	ISH- FUTBOLLISTI GJERMAN VERNER	UIDHESË NË ADRIATIK (shq.)			LAÇ	
INSTITUTI EKONOMIK			FUTBOLLISTI NË FOTO LART AKTORJA BEISINXHER														SHKOJ, ECI
ASHKLAT						VEGJA PËR KALKULIME HEJJI											
	FUTBOLLISTI NË FOTO POSHTË																I NJË GJINIE LETRARE OKSIGJEN
	SUEDI																
EMNAKJA E SEMIRIT								SHEGË								PEZMATIM I VESHIT (shq.)	

	E LLASTOJ, E PERKEDHEL TEJ MASE	TË QENËT LABIL	ALKETA VEJSIU	TERRORIZIMI	QË LIDHET ME ADENO- PATINE	NIKOLA VENTOLA	3 (romekje)	ISH-KRYEMI- NISTRI BRI- TANIK TONI	KORNIZA	ZANORJA E PARE	HATRI	ÇASTI, MOMENTI	VIKTIMA E MACES	OTILIA (dim.)	AKTORE ITALIANE	INVA MULA	NJË KAFSHË SHTETIAKE	
FUTBOLLISTI NË FOTO LART																		
FUTBOLLISTI NË FOTO POSHTË										IMITACIONE Ë S								
ANITA BITRI			REN FUJE METALI			I EMËRUAR IMPERIAL										NEUTRON RR NJ		
NJERIU SHUMË I MADH, DIVI, KOLOSI							DIÇKA E RE (shq.)						KOMBËTAR- JA E FUT- BOLLISTIT NË FOTON LART	NAZMI RRAHMANI SHTET NË EVROPE			LËRIM I ARES, KULTIVIM	
	KOMIKU AME- RIKAN XHEJ KOKRRAT E DRITËREAVE PER MBJELLEJE																	
SHKRIMTARI YNË SHIROKA																	RADIUS PULLË E PIANOS	
AGIM TEJECI			ZYRAT ARSI- MORE BREGORE, STOM														SHOQËRIA E ZGJEDHUR	
FSHU DIÇKA TE SHKRUAR																	SASIA E BARIT QË MERR PACIENTI (sh. shq.)	
GRINCA E IMËT E ELE- MENTEVE KIMIKE																	BALERINA GJONI (shq.)	
I NJË TIPI, TIPESOR																	PËREMËR VETOR	TIAGO MOTA

SERVICE CENTER

Shoqata Multikultura në suaza të programit të saj dhe në pajtueshmëri me masat për qëndrueshmëri përmes SERVICE CENTRE i ofron këto shërbime:

- Huazimi i laptopit, LCD proektorit etj.
- Tabelë Flip Charti
- Sallë për takime, me kapacitet deri 25 pjesëmarrës
- Përkrahje logjistike për takime, trajnime dhe punëtori
- Përkthime të materialeve nga gjuha angleze në gjuhën maqedone dhe anasjelltas; nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas; nga gjuha shqipe në gjuhën maqedone dhe anasjelltas
- Trajnime dhe përpilim të strategjive



MULTIKULTURA

Transporti i pajisjeve bie mbi barën e shfrytëzuesit. Nëse dëshironi të huazoni pajisjet e ofruara SERVICE CENTRE ju kërkohet që të na kontaktoni në e-mail adresën: info@multikultura.org.mk ose në numrin e telefonit 044 522 355 të paktë pesë ditë para datës së huazimit.



diversity day

all different, all equal

Agjenda:

- *Valle tradicionale*
- *Ushqime tradicionale*
- *Promovim i talentëve të rinj*
- *Këndi i fëmijëve*
- *Info-pika*
- *Party*

Dita: 15 Maj 2012

Vendi: Para Qendrës së Kulturës - Tetovë

Koha: 12:00 - 16:00

